

## EKSPERIENCA E KOSOVËS ME EUROIZIMIN E EKONOMISË SË SAJ

---

*Michel Svetchine\**

*Zonja dhe Zotërinj,*

I jam shumë mirënjohës Bankës së Shqipërisë, për ftesën e saj në këtë Konferencë të Pestë Ndërkombëtare. Jam i nderuar që të paraqes në këtë forum, Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës, një nga institucionet më të reja të mbikëqyrjes financiare dhe të “bankës qendrore” në Ballkan.

Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës (BPK) u krijua nga UNMIK-u në vitin 1999 për të mbikëqyrur zbatimin e strukturës monetare dhe financiare, për t’u kujdesur për një sistem efikas dhe të sigurt të pagesave, dhe për të mbështetur zhvillimin e një sektori financiar të shëndoshë në territorin e Kosovës.

Fillimisht, në nëntor të vitit 1999, objektivat më të rëndësishëm të BPK-s ishin mbikëqyrja bankare dhe kushtet e shërbimeve të pagesave, të cilat përfshinin furnizimin me një sasi të mjaftueshme të kartëmonedhave dhe monedhave. Më vonë, roli i BPK-së u rrit dhe u zgjerua, duke përfshirë licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e të gjitha institucioneve financiare (së bashku me sigurimin dhe fondet e pensioneve), në një vijë me tendencën e nisur nga MB dhe krijimi i Autoritetit të Shërbimeve Financiare.

## 1. SFIDAT E NDRYSHIMIT

### A) Përshtatja e dem

Një nga sfidat e shumta që Kosova përballoi pas konfliktit ishte zgjedhja e një strukture monetare. Duke patur parasysht ngutjen e madhe për zotërime në para të gatshme të këmbimit valutor dhe zhdukjen e dinarit jugosllav si një mjet transaksionesh, nuk ishte befasuese që në shtator të vitit 1999, me anën e një prej rregullave të tij të parë “Mbi monedhën e lejuar për përdorim në Kosovë”, UNMIK ligjëroi përdorimin e markës gjermane dhe të monedhave të tjera të huaja në Kosovë.

Në fakt, ishte popullsia e Kosovës e cila adoptoi markën gjermane si monedhën e saj të përbashkët. Rregulli i UNMIK-ut thjesht e identifikoi markën gjermane si monedhën me të cilën buxhetet, të dhënat financiare dhe llogaritë e organizmave publikë, agjencitë dhe institucionet, dhe vetë UNMIK-u, do të formuloheshin. Në të njëjtën kohë, ky rregull u ofronte palëve liri për çdo kontratë apo transaksion tjetër vullnetar, për të emërtuar një transaksion të tillë në një valutë të pranuar gjerësisht e të miratuar prej tyre. Për më tepër, ky rregull i largonte të gjitha kontrollet dhe kufizimet e këmbimit valutor, nga zotërimi, përdorimi apo vendosja e çdo valute, në monedha të gatshme apo në një llogari bankare, të ndodhura brenda apo jashtë territorit të Kosovës.

Marka Gjermane u adoptua në mënyrë të njëanshme, si një monedhë e ligjshme de facto në Kosovë, dhe nuk pati ndonjë negociatë me Bundesbankën Gjermane apo Bankën Qendrore Evropiane në atë kohë. Adoptimi i markës gjermane dhe më pas adoptimi i euros, nuk ishte i rastësishëm. Ai pasonte dy dekada të paqëndrueshmërisë ekstreme monetare, shoqëruar me një shkallë të lartë të përdorimit jozyrtar të markës gjermane si një rezervë vlerash dhe mjet shkëmbimi. Në periudhën e parakonfliktit, marka gjermane ishte valuta më e përdorur; kishte shuma të konsiderueshme të parave të gatshme në qarkullim. Popullsia ishte e familjarizuar me këtë monedhë. Paratë e dërguara nga diaspora kosovare, në vitin 2002 të vlerësuar në mbi 500 milionë euro, kishin shkaktuar një lëvizje të rregullt dhe të konsiderueshme të parave në Kosovë për

vite me radhë. Këto të hyra ishin pothuajse të gjitha në formën e parasë fizike. Pas fundit të konfliktit, në mungesë të shërbimeve bankare në Kosovë, pjesa më e madhe e asistencës direkte të huaj në Kosovë gjithashtu, i bënë të nevojshme të hyrat e parasë fizike.

Në kohën kur Kombet e Bashkuara morën administrimin e Kosovës, adoptimi i strukturës monetare bazuar në përdorimin e markës gjermane u paraqit si një zgjedhje e natyrshme. Përdorimi i një monedhe të qëndrueshme ishte i rëndësishëm në mirëmbajtjen e një stabiliteti makroekonomik dhe luante një rol vendimtar në rindërtimin e besimit të njerëzve në sektorin financiar. Ajo gjithashtu, u përcaktua që të siguronte një mbështetje domethënëse për një strategji zhvillimi të drejtuar nga jashtë, e cila më shumë sesa një zgjedhje ishte një nevojë, duke patur parasysh përmasat e tregut të brendshëm.

#### B) Shndërrimi nga dem në euro

Kur në fillim të vitit 2002 u bë zëvendësimi i monedhave të trashëguara në euro në vendet e Eurozonës, u bë gjithashtu i nevojshëm zëvendësimi i Markës Gjermane në Kosovë. BPK-së iu besua drejtimi i këtij projekti me qëllim sigurimin e një ndryshimi të qetë dhe të sigurt në euro, dhe mundësisht me kosto sa më të ulët. Mbështetja e pakufizuar për këtë projekt nga UNMIK-u dhe BE siguroi ndihmën e nevojshme dhe të fortë në ndryshimin dhe miratimin e legjislacionit themelor.

Në ndryshim me “adoptimin” e markës gjermane si monedha kryesore në Kosovë në vitin 1999 ose për ta përshkruar më mirë, legalizimi i përdorimit të gjerë të saj, kalimi në euro duhet të bëhej në bashkëpunim me Bankën Qendrore Evropiane, si edhe me disa banka qendrore kombëtare në Eurozonë. Me të vërtetë, futja në përdorim e kartëmonedhave dhe e monedhave Euro duhej të bëhej me ndihmën dhe asistencën e vendeve të Zonës Euro.

Rrethanat e veçanta me të cilat përballeshin autoritetet në Kosovë, shfaqën sfida të shumta në përgatitjen për tërheqjen e markës gjermane dhe injektimin e euros. Shkalla e lartë e orientimit të parave të gatshme në ekonomi nënkuptonte që nuk kishte mënyrë

direkte për vlerësimin e vëllimit të markës gjermane në qarkullim dhe për rrjedhojë, shpërndarjen e saj sipas denominacioneve. Bazuar në vendimet e marra nga BQE (Banka Qendrore Evropiane), e cila i lejonte bankat qendrore të jo-Eurozonës që të shpërndanin kartëmonedhat dhe monedhat euro nga fillimi i dhjetorit të vitit 2001, BPK-ja vendosi që të shpërndaheshin rreth 100 milionë euro përpara 1 janarit të vitit 2002.

## 2. PËRFITIMET E EUROIZIMIT

### A) Mbështetja për zhvillimin e sektorit financiar

Eurozimi mbështeti zhvillimin e sektorit financiar të Kosovës, i cili duhej të krijohej nga fillimi pas konfliktit. Në fillim, në Kosovë nuk kishte banka dhe praktikisht të gjitha transaksionet bëheshin në para të gatshme. Në fakt, për gati dy vite, në Kosovë nuk kishte sektor financiar dhe entiteti i vetëm financiar, Micro Enterprise Bank (MEB), ishte i specializuar në mikrokredi. Megjithatë, dy vitet e ardhshme dëshmuuan një zhvillim të vullshëm të ndërmjetësimit financiar në Kosovë, veçanërisht atë të sektorit bankar. Më 15 marsit dhe nëntorit 2001, u themeluan gjashtë banka, të cilat sollën një konkurrencë aq të nevojshme në këtë sektor.

Në vitet 2002 dhe 2003, shtatë bankat tregtare të Kosovës u zgjeruan në mënyrë domethënëse. Duke patur parasysh përmasat e vogla të ekonomisë dhe popullsisë së Kosovës, dhe përvojat negative me bankat në të kaluarën, sistemi financiar i Kosovës karakterizohet nga një pjesëmarrje e fuqishme e entiteteve të huaja. Bankat evropiane tregtare, së bashku me agjencitë e zhvillimit dhe institucione të tjera financiare, janë bërë aksionerët kryesorë të dy bankave më të mëdha të Kosovës. Banka Amerikane e Kosovës u krijua me pjesëmarrje kapitali nga USAID në nëntor 2001, dhe iu shit në fillim të vitit 2003 të bankës “Raiffeisen”. MEB u emërtua ProCredit Bank në gusht të vitit 2003. Pesë bankat e tjera kanë sipërmarrës vendas si aksionerët e tyre kryesorë.

Në fund të dhjetorit 2004, sistemi financiar i Kosovës përbëhej nga 7 banka, të cilat operonin përmes 247 zyrave, 14 institucione

mikrofinanciare, 3 institucione të tjera jobankare, 7 kompani sigurimi and 1 kompani kursimi për pensione. Sistemi bankar i Kosovës mbulon një territor të gjerë geografik. Ka një degë për përafërsisht çdo 9 000 banorë, larg nga vendet e zhvilluara të cilat kanë një degë për çdo 1 500 banorë. Mjetet gjithsej të institucioneve bankare në dhjetor 2004, arritën shumën 700 milionë euro, e barabartë me 40 për qind të PBB-së. Kapitali i sistemit bankar në fund të vitit 2003 ishte 45 milionë euro. Të gjitha bankat e Kosovës arrijnë të përmbushin, dhe pjesa më e madhe e tejkalon, shumën minimale të kërkuar të kapitalit, të cilën BPK e rriti me 4 milionë euro në dhjetor 2003, duke e sjellë atë në një vijë me udhëzimin e BE-së prej 5 milionë eurosh.

#### B) Pakësimi i parasë fizike nga qarkullimi

Pakësimi i parasë fizike nga qarkullimi ishte një nga objektivat kryesorë të BPK-së. Ndryshimi siguroi një mundësi unike për ta arritur këtë objektiv dhe në të njëjtën kohë ndihmoi në forcimin e sistemit bankar. BPK-ja planifikoi që t'i këmbente shumat familjare deri në 1,000 marka gjermane për një person falas, dhe vendosi një tarifë prej 2 për qind për shumat ndërmjet 1,000 dhe 10,000 marka gjermane; kjo gjithashtu ishte edhe shuma maksimale e lejuar e këmbimit të parasë fizike. Shumat të cilat e tejkalonin 10,000 dm duhej të vendoseshin si depozita bankare në euro. Në të njëjtën kohë, u bë çdo përpjekje për të lehtësuar rolin e ndërmarrjeve të shitjeve në heqjen e markës gjermane nga qarkullimi përmes një procesi të natyrshëm.

Vendosja e kufijve maksimalë mbi shumat e këmbimit, si edhe përcaktimi në mënyrë të qartë i afatit të fundit të periudhës së qarkullimit të dyfishtë të monedhave, i inkurajoi së tepërmi mbajtësit e parasë fizike që t'i depozitonin paratë e tyre në banka, në vend që të rrezikonin që të mos t'i këmbenin ato në kohë. Kjo strategji u shoqërua me stimuj nga bankat, të cilat tashmë kishin përmirësuar dhe shumëfishuar shërbimet e tyre, për të tërhequr klientë të rinj që të hapnin llogaritë e tyre. Edhe pse ky skenar duket i thjeshtë, zbatimi i tij paraqiste disa probleme. Problemi më i rëndësishëm, sigurisht, ishte mungesa e vazhdueshme e besimit në sistemin bankar. Kjo u rëndua më së tepërmi nga një akses ende i kufizuar i shërbimeve bankare. Në këtë kohë, bankat tregtare të Kosovës

kishin në dispozicion vetëm 24 zyra, ndërsa BPK operonte përmes një rrjeti pune prej 23 zyrash, nga të cilat më shumë se gjysma ishin agjenci të vogla lokale, të cilat hapeshin vetëm me orare të kufizuara, dhe 7 grupe bankash të lëvizshme. Megjithatë, periudha tremujore përpara zëvendësimit të parasë fizike, shënoi një rritje prej afërsisht 300 milionë eurosh në depozitat bankare. Sot, depozitat bankare gjithsej janë përafërsisht 600 milionë euro. Megjithatë, “monedha në qarkullim” në Kosovë në raport me depozitat është 75 deri 85 për qind, ende një nga më të lartat në botë.

Hedhja në qarkullim e euros përfundoi me sukses më 28 shkurt 2002. Kështu, nga ky moment, ekonomia e Kosovës është “euroizuar” tërësisht dhe në mënyrë të efektshme. Eurozimi shpesh përkufizohet si adoptimi i Euros si monedhë ligjore dhe monedhë zyrtare nga autoritetet e një vendi jashtë Zonës Euro. Ky përkufizim nënkupton gjithashtu, që autoritetet vendosën që të refuzonin instrumentet e politikave të tyre monetare dhe të braktisnin monedhën e tyre kombëtare. Duhet të theksoj sërish se rrethanat e Kosovës paskonfliktit ishin, dhe ende janë, disi specifike, politikisht dhe ekonomikisht. Duke marrë parasysh përdorimin e gjerë jozyrtar të markës gjermane dhe rolin e saj, i cili është shumë i madh, sa ndryshe mund të quhet thjesht një monedhë paralele, UNMIK-u e pranoi këtë zgjedhje si një “fait accompli” (fakt i kryer).

### C) Stabiliteti monetar

Në kohën kur Kosova zgjodhi eurozimin, inflacioni vjetor ishte mbi 40 për qind. Monedha e saj zyrtare (dinari) u zhvlerësua tërësisht dhe përdorimi i saj ishte pothuajse joekzistues. UNMIK-u nuk po zëvendësonte thjesht një monedhë kombëtare të zhvlerësuar, por gjithashtu po vendoste në Kosovë një themel monetar të shëndoshë të nevojshëm për rindërtimin ekonomik, shoqëror dhe politik në vitet që do të pasonin.

Inflacioni në Kosovë nuk u zhduk në mënyrë të menjëhershme pas futjes në përdorim të markës gjermane dhe më pas të euros. Në vitet 2000-2001, Kosova shënoi një inflacion dyshifror, ndihmuar edhe nga ndihmat e huaja të mëdha dhe të hyrat private. Për rrjedhojë, inflacioni, u ngadalësua në mënyrë të theksuar dhe tashmë është nën

mesataren e inflacionit të Zonës Euro. Sigurisht, ka faktorë të tjerë kontribues përveç euroizimit, si për shembull, papunësia e lartë dhe aktiviteti i ulët ekonomik.

Adoptimi i euros si një monedhë kombëtare solligjithashtu, stabilitet monetar në Kosovë. Rreziku i zhvlerësimit të monedhës kombëtare u zhduk. BPK-ja, e cila vepron si një agjent fiskal për administratën lokale, nuk ndërmer rrezik këmbimi, ndërsa administron rezervat zyrtare. Këto rezerva investohen kryesisht brenda vendeve të Zonës Euro, në banka qendrore dhe në institucione financiare me norma të larta. Ekonomia e Kosovës nuk përballon rreziqe këmbimi domethënëse. Në të njëjtën mënyrë, euroizimi ka penguar që në Kosovë të ketë normë të dyfishtë këmbimi të monedhës, ligjore dhe informale. Kjo në fakt duhet të çojë në një kosto më të ulët të huamarrjeve dhe në rritjen e investimeve, në nxitjen e rritjes ekonomike dhe të mirëqenies. Ndryshe nga diferencat e inflacionit ndërmjet Kosovës dhe Zonës Euro, kontrasti i normës së interesit vazhdon të jetë domethënës. Ndërsa normat e depozitave bankare u ulën në nivelet e Zonës Euro, normat e interesit të huave vazhdojnë të jenë më të larta. Normat e interesit të huave luhaten në rreth 9-14 për qind dhe janë më të larta sesa në pjesën më të madhe të vendeve perëndimore, ndërkohë që normat e depozitave janë ulur në rreth 21/2-4 për qind. Faktorët që kanë kontribuar këtu janë niveli i rreziqeve që hasen nga huadhënësit, ndër të cilat një mungesë e vazhdueshme e llogarive të besueshme, një strukturë ligjore e dobët, si edhe pasiguria e statusit të Kosovës.

#### D) Zvogëlimi i koston së transaksionit

Futja në përdorim e euros i thjeshtësoi dhe i zvogëloi dukshëm kostot e transaksionit, veçanërisht kur marrim parasysh rëndësinë e tregtisë brenda ekonomisë së Kosovës. Vendet fqinje, kryesisht Republikat ish-Jugosllave, mbeten partnerët kryesorë të tregtisë së Kosovës. Megjithatë, euro, ashtu si edhe marka gjermane përpara vitit 2002, përdoret gjerësisht në rajon. Deficitet e konsiderueshme të bilancit tregtar, të cilat ishin rreth 85 për qind të PBB-së në vitin 2003, vazhdojnë të jenë shqetësuese në Kosovë. Për momentin, këto deficite mbulohen nga paratë e dërguara dhe ndihmat e donatorëve, por me një rrezik në rritje të këtyre dy burimeve të cilat do të

zvogëlohen gradualisht në vitet e ardhshme, kjo çështje duhet të adresohet në mënyrë urgjente.

#### E) Stabiliteti makroekonomik

Euroizimi në Kosovë kishte gjithashtu disa objektiva politike afatgjatë. Nga shumë kjo konsiderohet si “i pakthyeshëm”. Euroizimi në Kosovë pritet që të kujdeset për stabilitetin ekonomik, të zgjidhë problemin e besueshmërisë, por kryesisht të rrisë disiplinën fiskale duke eliminuar mundësinë e riprodhimit të parave për të mbuluar deficitet fiskale. Pas një periudhe më të gjatë kohore, kur të plotësohen kushtet e tjera gjithashtu, kjo duhet të çojë në rritjen e investimeve të drejtpërdrejta të huaja.

Përgjithësisht, euroizimi pritet që të kujdeset për integrimin ekonomik të vendit, i cili ka adoptuar euron me ekonominë e vendit të emetimit të euros, në këtë rast e gjithë Zona e Euros. Tashmë vendi adoptues ka një ekonomi më të fortë ose lidhje politike me vendin emetues. Euroizimi në Kosovë nuk e ndoqi këtë strukturë, pasi ishte një rezultat direkt i shpërbërjes politike dhe ekonomike të ish-Jugosllavisë, dhe i ndërhyrjes së Kombeve të Bashkuara. Por duke parë në të ardhmen, kjo në fakt duhet të shpejtojë integrimin e plotë të Kosovës në Zonën e Euros.

#### F) Kostoja e euroizimit

Euroizimi, ndonëse kishte efekte pozitive mbi ekonominë, gjithashtu solli kosto. Edhe nëse e përjashtojmë koston e ndryshimit fillestar të parave të gatshme euro, humbja e të ardhurave nga “e drejta e zotëruesit”, dhe kostoja e mundësisë së mbajtjes së rezervave të parasë fizike për Bankën Qendrore, e çon në shumën të konsiderueshme. Megjithatë, kostot mund të konsideroheshin të përballueshme, krahasuar me përparësitë e euroizimit.

Muajt e fundit, BPK ka iniciuar një dialog me Bankën Qendrore Evropiane, e cila ka çuar në nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet këtyre dy institucioneve. Ky Memorandum e lehtëson BPK-në nga një pjesë e barrës financiare që ka të bëjë me transportin e kartëmonedhave dhe të monedhave euro në

qarkullim në Kosovë. Si rezultat i nivelit të lartpërmendur të parave të dërguara dhe i natyrës së tyre si para fizike, Kosova ka qenë një eksportues neto i kartëmonedhave euro që prej mesit të vitit 2002. Gjithashtu, mund të shtoj që edhe me kontrollet tona strikte të hyrjes së parave të gatshme në kufi, ne priremi që të procesojmë më shumë kartëmonedha, madje edhe monedha, çka mund të pritet në një ekonomi të vogël si ajo e Kosovës. Unë do t'i mirëprisja disa diskutime të mëtejshme me fqinjët tanë lidhur me këtë temë, pasi kjo mund të na ndihmojë të gjithëve për ta zgjidhur këtë problem në një kohë më të gjatë.

Vërejtja e fundit që unë doja të bëja mbi kostot e euroizimit, ka të bëjë me atë për të cilën shqetësohen të gjithë bankierët qendrorë, kjo është mundësia e një prej bankave nën mbikëqyrjen tonë që të zhvillojë probleme likuiditeti. Pas adoptimit të njëanshëm të euros, një bankë qendrore po përballet me më shumë kufizime në përmbushjen e funksionit të saj të huadhënies. Megjithatë, në kontekstin e adoptimit të njëanshëm të euros, është e përfytyrueshme që një bankë qendrore të sigurojë likuiditet për bankat tregtare, por jo në masë të madhe, për shkak të sfidës së një Banke Qendrore që të japë hua më shumë sesa vetë fondet e saj. Ne të gjithë e kuptojmë se falimentimi i një institucioni, në një mjedis të brishtë në të cilin punojmë, mund të përhapet në mënyrë të shpejtë dhe të kërcënojë shlyerjen e së gjithës, pra të një sistemi të shëndoshë bankar. Trajtimi ynë i këtij problemi është i dyfishtë. Ne mbajmë në disponim rezerva të parave të gatshme, të cilat mund të përdoren në rrethana të jashtëzakonshme, por fillimisht ne i përqëndrojmë përpjekjet tona në mbrojtjen e sistemit kundrejt një rasti të tillë. Ne e bëjmë këtë përmes një mbikëqyrjeje shumë rigoroze, të plotë dhe të përpiktë.

Në përfundim, nëse euroizimi nuk i ka zgjidhur të gjitha problemet financiare në Kosovë, dhe nëse euroizimi ka sjellë kufizime në drejtimin e një politike të pavarur monetare, përparësitë e tij pa dyshim janë pozitive, kryesisht sepse përdorimi i euros ka ndikuar në stabilitetin e sektorit financiar.

*Shumë faleminderit për vëmendjen tuaj.*

\* Michel Svetchine: Drejtor i Përgjithshëm, Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës.

